2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të ketë një numër minimal prej 15(*punonjës*) punonjësish të punësuar, të cilët duhet të rezultojnë në listëpagesa për periudhën për periudhën **Tetor 2019 – Qershor 2020**, për përmbushjen e këtij kushti duhet të paraqesë:

- Vërtetim lëshuar nga organet tatimore,
- Listëpagesat e deklaruar përmes formës elektronike ku të jetë i specifikuar numri i punonjësve për çdo muaj,

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të jete i paisur me liçensat profesionale të vlefshme të kategorisë NS13-A dhe NS14-A.

Operatori ekonomik duhet të jete i pajisur me licensa profesionale të vlefshme të kategorise 4C ne projektim ne rrjete elektrike, per objektet civile e industrialdhe te kategorise 4J ne projektim te rrjeteve te telefonise, citofonise, fonise , internetit, TV, akses kontroll, CCTV, sistemet e alarmit, sistemet e detektimit te zjarrit, etj, per objektet civile e industrial

License profesionale per inxhinier elektronik te vlefshme te kategorise 4C ne projektim ne rrjete elektrike, per objektet civile e industrialdhe te kategorise 4J ne projektim te rrjeteve te telefonise, citofonise, fonise , internetit, TV, akses kontroll, CCTV, sistemet e alarmit, sistemet e detektimit te zjarrit, etj, per objektet civile e industrial

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar pjesë të stafit të paktën:

a. **2(dy)inxhiniera elektronik, 2(dy)inxhiniera elektrik dhe 1(një)punonjësme specialitetin: informaticien (IT)**

b. Të paktën 2 (dy) punonjës të jenë të pajisur me dëshmi të kualifikimit të sigurimit teknik.

të cilët të figurojnë me këtë kategori profesioni në listëpagesat e shoqërisë, si dhe të paraqiten:

- Kontrata Individuale pune *(të vlefshme)*
- Diploma e arsimit të lartë

i. Në mënyrë që të krahasohet pajtueshmeria me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara, ditën e hapjes së ofertave, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pranë autoritetit kontraktor **një mostër për:**

- Kamera e jashtme Bullet
- Kamera 360 grade
- Pajisjen Regjistruese NVR
- Monitori
- Switch
- Centrali i alarmit
- Tastiera
- Sensor Volumetrik
- Sensor temperature
- Sirena e jashtme
- Central Aksesit
- Reader Indoor

▪ **Mosdorëzimi i mostrës për secilën pajisje të kërkuar ditën e hapjes së ofertave përbën kusht për s'kualifikim.**

- Gjithashtu me lëvrimin e mallit, furnizuesi i mundshëm duhet të paraqesë:

- a. Çertifikatë cilësie prodhuesi.
- b. Çertifikatë Origjine.
- c. Çertifikatë Garancie minimumi 12 *(dymbëdhjetë)* muaj nga marja në dorëzim e mallit.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Në rast se Operatorët Ekonomikë do të paraqesin dokumentacion në gjuhë të huaj, dokumentat duhet të përkthehen në shqip dhe të noterizohen. Përrjashtim bën vetëm Katalogu, i cili mund të jetë dhe në gjuhën Angleze. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për s'kualifikim.

1. Implementimi te sistemeve

Aktualisht Bashkia Lushnje do të kryej vendosjen, Instalimin dhe konfigurimin e sistemit CCTV i cili do të integrohet me rrjetin ekzistues data dhe sistemet e tjera të cilat lidhen me te. OE duhet të përshtasi rrjetin për transmetimin e të dhënave të sistemit CCTV në rrjetin LAN, Optic Fiber dhe WAN, duhet te montoje kamera dhe gjithë aksesoret e nevojshem per funksionimin e tyre. OE fitues pas përfundimit të projektit duhet te paraqesi per aprovim skemat teknike te rrjetit WAN si dhe ti certifikojte rezultatet duke perdoru pajisje te posacme per testimin e rrjetave të transmetimit duke printuar raportint teknik te rezultatit te testimeve.

Eshte vendosur sistem akses kontrolli per dhomen e IT per rritjen e sigurise ne kete dhome teknike, pasi ketu do te montohet edhe paisja e rregjistrimit te kamerave. Aksesit ne dhome do te jete sipas kerkesave te klientit per numrin e perdoruesave.

Sistemi I akses kontrollit do te perdoret kryesisht per limitimin e aksesit ne zonen e dhomes teknike(Raku). Gjithashtu duhet te jete me prespektive per shtim te kapacitetit te tij ne te ardhmen per ambjente te tjera te institucionit ku do nevojitet akses I limituar. Ky system duhet te jete bashkekohor dhe te plotesoj te gjitha kerkesat per nje nivel sigurie te larte dhe ne standartet Europiane. Sistemi duhet te kete bateri te integruara per autonomi nga energjia elektrike. Gjithashtu per realizimin e sistemit te akses kontrollit ne dhomen teknike(Raku) duhet te perdoren kondrabrava elektrike dhe krahe hidraulik sipas standartit te kerkuar.

Po ashtu eshte vendosur nje sistem alarmi i grades 3 per kete dhome ne rast se thyhet siguria. Sistemi lajmeron perdoruesit paraprakisht te konfiguruar nepermjet thirrjeve apo mesazheve telefonike.

Per dhomen teknike eshte parashikuar edhe sistemi I monitorimit te temperatures nepermjet sensoreve te dedikuar te rack-ut, I cili eshte pjese e sistemit te alarmit.

1.1 Lista e pajisjeve CCTV

Video Regjistrator Rrjeti-NVR min 64 kanale

Karakteristika t	Vlerat specifik e minimale
Numri I kanaleve hyrëse	64 kanale ose me shume
Incoming Bandwidth	320Mbps
Rezolucioni maksimal ne regjistrim	Deri ne 12 MP
Nderfaqja	2 x HDMI, 2 x VGA

Dokumentat Standarde të Tenderit

Syncron Playback	Min 16 kanale
Formati I Vidios	H.265 ose me mire
Hdd	Min 10TB Te jete i dizenuar per pune me intensitet te larte dhe pa ndërprerje Te jete i përshtatshëm per sisteme regjistrimi te videove
eSATA	Minimumi 1 x eSATA port
Numri i HDD	Minimumi 8 nderfaqe per montim HDD
Porta e rrjetit	Min RJ-45 10/100/1000 Mbps
Portat USB	2xUSB 2.0 ose me shume; 1xUSB3.0 ose me shume
Nderfaqje seriale	RS-232, Rs-485
Funksionalitete	Dedektim I kalimit te vizes, intrusion dedection, region entrance, object removal, unattended baggage dhe dedektim i cfokusimit, te suportoje Video Analytics, te suportoje ANR ne menyre qe te sigurohet rimarrja e filmimeve kur ka shkeputje te rrjetit.
RAID	Te suportoje RAID0, RAID1, RAID5, RAID6 RAID10
Temperaturat e operimit	-10 deri ne +50°C
Alarm Out	Min 4
Periudha e Mbulimit të Garancisë “Warranty”:	1 Vit

Kamer e Jashtme Bullet

Karakteristikat	Vlerat specifike minimale
Tipi i kamerës (“Type of camera”)	Bullet
Procesori i figurës (“Image Sensor”)	Progressive Scan CMOS sensor 1/2.9”
Rezolucioni i figurës (“Resolution”)	3072 × 2048
Frekuenca e kuadrove (“Frame Rate”)	minimumi 20 fps
Reduktimi i zhurmës (“Noise Reduction”)	3D.DNR
Tipi i lenteve (“Lens Type”)	Fikse
Gjatësia fokale (“Local length”)	2.8 – 6 mm

Dokumentat Standarde të Tenderit

Ndriçimi Infra të Kuqe (“IR illuminators”)	Po; min 50 m;
Rezistenca	IP67
Diapazoni dinamik i djeshmërisë, (Wide Dynamic range)	Po (“Yes”) , 120dB
Formati i kompresimit të Videos	H.265 ose me mire
Dedektim i lëvizjes (“Motion Detection”);	Po (“Yes”)
Funksionalitete te tjera	Line crossing dedection,intrusion dedection,region exsiting dedection, face detection
Perimresim te imazhit	BLC/ HLC
Memorie Shtese SD Card	Po (Yes)
Temperatura e operimit (“Operating Temperature”)	-30°C + 55°C
Ushqimi (“Power”)	PoE, dhe 12VDC
Multi-streaming	Min.2 stream
Aksesore per montimin	Po sipas tipit te kameras dhe menyres se montimit
Periudha e Mbulimit të Garancisë “Warranty”:	1 Vit
Karakteristikat	Vlerat specifike minimale
Tipi i kamerës (“Type of camera”)	Bullet
Procesori i figurës (“Image Sensor”)	Progressive Scan CMOS sensor 1/2.5”
Rezolucioni i figurës (“Resolution”)	3840 × 2160
Frekuenca e kuadrove (“Frame Rate”)	minimumi 15 fps
Reduktimi i zhurmës (“Noise Reduction”)	3D.DNR
Tipi i lenteve (“Lens Type”)	Fikse
Gjatësia fokale (“Local length”)	2.8 – 6 mm
Ndriçimi Infra të Kuqe (“IR illuminators”)	Po; min 50 m;
Rezistenca	IP67
Diapazoni dinamik i djeshmërisë, (Wide Dynamic range)	Po (“Yes”) , 120dB
Formati i kompresimit të Videos	H.265 ose me mire
Dedektim i lëvizjes (“Motion Detection”);	Po (“Yes”)
Funksionalitete te tjera	Line crossing dedection,intrusion dedection,region exsiting dedection, face detection
Perimresim te imazhit	BLC/ HLC

Dokumentat Standarde të Tenderit

Memorie Shtese SD Card	Po (Yes)
Temperatura e operimit (“Operating Temperature”)	-30°C + 55°C
Ushqimi (“Power”)	PoE, dhe 12VDC
Multi-streaming	Min.2 stream
Aksesore per montimin	Po sipas tipit te kameras dhe menyres se montimit
Periudha e Mbulimit të Garancisë “Warranty”:	1 Vit

Kamera PTZ 360 Grade

Karakteristikat	Vlerat specifikë minimale
Tipi i kamerës (“Type of camera”)	PTZ
Procesori i figurës (“Image Sensor”)	1/1.9 CMOS
Rezolucioni i figurës (“Resolution”)	Minimumi 2560 × 1440
Frekuenca e kuadrove (“Frame Rate”)	MAX 50/60fps ne 1080P
Reduktimi i zhurmës (“Noise Reduction”)	3D DNR
Gjatësia fokale (“Local length”)	6 – 115 mm
Zmadhim Optik (Optical zoom)	20x
Zmadhim Digital (Digital zoom)	15x
Pan/ Tilt Range	Pan 360° endless, Tilt -15° to 90°(Auto Flip)
Ndriçimi Infra të Kuqe (“IR illuminators”)	Po; deri ne 150m;
Rezistenca	IP66
Mbrojtja ndaj rrufeve (Lighting protection)	TVS 4000V
Formati i kompresimit	H265
Funksionalitete te tjera	Auto tracking White Balance, ANR, Face detection, Intrusion detection, Line Crossing, Region Entrance, Region Exit, Video Tampering
Permiresim I imazhit	BLC/ Digital WDR/ EIS/ Defog
System supported	ONVIF
Nderfaqja e rrjetit	1 RJ45 10 M/100 M Ethernet Interface,
Kompresimi Video	Minimalisht ne tre Stream
Temperatura e operimit (“Operating Temperature”)	-30°C + 60°C

Dokumentat Standarde të Tenderit

Aksesore per montimin	Po sipas tipit te kameras dhe menyres se montimit
Periudha e Mbulimit të Garancisë “Warranty”:	1 Vit

Monitore Profesional

Screen Size (measured diagonally) :	49 - 55 (Polsh) inch
Display Resolution	3840 × 2160@60Hz/ 4K
Tipi i Panelit	LED
Brightness	300 cd/m ²
Koha e Pergjigjjes	< 8 ms
Kendi I shikimit	Horizontal 178°, Vertical 178°
Portat Hyrese	1x LAN, 1x VGA, 2x HDMI, 1x AV, 1x USB 2.0, 1x USB 3.0
Portat Dalese	SPDIF, Loudspeaker
Temperatura e operimit	0 °C ~ 40 °C
Lageshtia e operimit	10 to 90 %
Lloji i Rrymes Elektrike	100 to 240 VAC, 50/60Hz
Garancia	1 vit

Switch 5 Porta POE

Portat Ethernet	4 x 100M PoE ports, 1 x 100M Ethernet port
Konsumi POE	Port 1-4 < 30W
Protokollet POE	IEEE 802.3af, IEEE 802.3at
Switch Capacity	1 Gbps
MAC Table size	1K
Ushqimi	48 VDC, 0.8 A
Temperatura e operimit	0 °C to 40 °C
Garancia	1 vit

Workstation

RAM > Jo me i vogel se 8GB DDR4

Kapaciteti i HDD > Jo me i vogel se 2TB

Portat e komunikimit > 4x USB 2.0, 2x USB 3.0, 1x Porte seriale, 2x Porta ethernet

Rrjeti > Ethernet port 2x 10/100/1000 LAN

Sistemi i operimit > Windows server

2. Implementimi I sistemit te alarmit

Sistem I alarmit duhet te jete nje sistem bashkekohor i cili te mundesoj mbrojtjen nga vjedhja ose nderhyrja ne ambientet e dhomes teknike(Raku).

2.1 Centrali i alarmit

- Të suportojë jo më pak se 64 zona për sensorët duke shtuar expander
- Të ketë mundësinë të lidhen me të jo më pak se 32 tastiera
- Të jete i pajisur me porta RS 485/USB, për komunikime/kontrolle/konfigurime
- Të ketë mundësi të aksesohet nga jo më pak se 500 përdorues me të drejta të ndryshme aksesit
- Të ketë kapacitet të ruajë jo më pak se 2000 evente
- Të ketë funksione diagnostikimi: Për të gjithë sensorët, furnizimin me energji elektrike, bateri, pajisjet e lidhura (expander apo module)
- Të ketë Bateri të integruara për autonomi jo më pak se 24 orë
- Të evidentojë ndërhyrjet në central
- Të ketë mundësi për ndërfaqe Ethernet TCP-IP
- Të jete i pajisur me linje PSTN dhe GSM për thirrje telefonike deri në 64 numra.
- Të ketë ndërfaqe komunikuese ose rele me sisteme apo pajisje të tjera
- Të ketë mundësinë e ndarjes së elementëve në jo më pak se 64 sektorë të ndryshëm
- Të jetë i pajisur me tamper për mbrojtje ndaj hapjes së tij
- Të ketë mundësinë e menaxhimit dhe diagnostikimit në distancë nëpërmjet një software menaxhimi
- Paneli duhet të plotësojë standartet Europiane dhe të ketë Grade 3 sigurië
- Moduli i ushqimit të këtij çentrali të ketë këto karakteristika :
 - Të jenë kompatibël me të gjithë elementët e sistemit
 - Të ketë në dalje tension të rregulluar e me kufizim rryme
 - Hyrje, 220 VAC $\pm 10\%$, 50 Hz
 - Certificate konformiteti(Aproval Certificate) sipas standarteve të bashkimit Europian

2.2 Tastierë komandimi për sistemin e alarmit.

- Të komunikojë, kontrollojë dhe administrojë centralin e alarmit
- Të jetë e pajisur me ekran dhe me butona
- Të suportojë teknologjinë NFC për aktivizimin dhe çaktivizim e sistemit
- Të sinjalizojë në raste të ndryshmeve të statusit të çentralit
 - Certificate konformiteti(Aproval Certificate) sipas standarteve të bashkimit Europian

2.3 Sensor Levizje (Volumetrik)

- Të jetë me dopioteknologji (IR dhe Microwave)
- Të ketë një cilësi të lartë optike të pasqyrës (zonës optike).
- Të ketë një rreze detektimi jo më pak se 15m në një kënd deri në 90°
- Të ketë mundësi të gjenerojë alarme në tre mënyra: në dy teknologji njëkohësisht, vetëm në IR dhe vetëm në Microwave

Dokumentat Standarde të Tenderit

- Të jetë i pajisur me teknologjinë Pet Immunity për mbrojtje të sistemit nga alarme false që mund të gjenerohen nga kafshët e vogla
- Të jetë i pajisur me teknologjinë Antimask
- Të jete i pajisur me tamper dhe accelerometër, për mbrojtje ndaj hapjes apo tentimit të spostimit të tij.
- Temperatura e punës 0 ° C deri + 50° C
- Sensori duhet te plotesoje standartin e sigurise EN50131 te Grades 3.
- Certificate konformiteti(Aproval Certificate) sipas standarteve te bashkimit European

2.4 Sensor Temperature

- Të ketë mundësi gradimi të temperaturës së detektimit nga 0°C deri +60°C me limit te ulët dhe te lartë temperature per konfigurim
- Te kete mundesi shtimi te nje sonde per temperatura me diapazon me te larte detektimi nga -40 deri ne 60 grade Celsius
- Te punoje ne voltazh ne hyrje nga 9-15VDC
- Te jete I pajisur me 2 dalje Relay te vecanta per perdorime te ndryshme
- Te jete I pajisur me alarm akustik per lajmerim kur temperature ka kaluar nivelin e paraprogramuar
-

2.5 Sirena e jashtme

- Sirena duhet te jete mundesi te punoje nga 10 - 15Vdc
- Fuqia e sirenes te jete minimumi 105 db
- Sirena duhet te jete e pajisur me tamper
- Sirena duhet te jete e pajisur me led ndricues
- Sirena duhet te jete e pajisur me kase metalike per mbrojtje te brendshme
- Sirena duhet te kryeje funksionet e tij ne temperatura nga -25 grade celsius deri +55 grade celsius
- Sirena te kete nivel sigurie IP34

2.6 Program i menaxhimit të sistemit të alarmit

Programi të ketë mundësinë e lidhjes me centralin si dhe konfigurimin dhe ndryshimin e parametrave të centralit :

- Të ketë mundësinë e ndryshimit, shtimit, heqjes së të drejtave të çdo përdoruesi
- Të ketë mundësinë e aktivizimit dhe çaktivizimit të zonave apo elementëve të veçantë

- Të ketë mundësinë e ndryshimit, shtimit, heqjes së programeve të regjistruara për njoftim,
- Të ketë mundësinë e ndryshimeve të kohës së aktivizimit të sensorëve/zonave
- Të ketë mundësinë të shohë në kohë reale statusin e centralit, tastierave dhe sensorëve
- Të ketë mundësinë e aktivizimit dhe çaktivizimit të daljeve të centralit.
- Të ketë mundësinë e aktivizimit dhe çaktivizimit të centralit në distancë
- Të ketë mundësinë e shfaqjes dhe kopjimit të të gjitha eventeve që gjeneron centrali
- Të ketë mundësinë e gjenerimit të raporteve në formatet PDF/Excel/Text të eventeve që kanë ndodhur sipas centralit, kohës apo eventit.
- Të sinjalizojë në mënyrë automatike ndryshimet e statusit të centralit të alarmit

3 Implementimi i sistemit të Akses Kontrollit

Specifikime teknike

Centrali i aksesit.

- Centrali i akses kontrollit të suportoje të pakten deri në dy reader. Të ketë mundësinë duke shtuar panel zgjerues të suportoje deri në 8 reader.
- Centrali duhet të suportoje mbi 10000 on-board card database
- Duhet të ketë mundësi të mbaje në buffer mbi 2000 evente
- Centrali duhet të ketë mundësi krijimi mbi 250 nivele aksesi(access levels)
- Centrali duhet të ketë mundësi krijimi mbi 250 schedule oraresh
- Centrali duhet të ketë mundësinë të perdore deri në 16 hyrje(inputs) për përdorim të ndryshëm
- Duhet të ketë mundësinë të suportoje formate të ndryshme universale si: Wiegand/ Track 2 ABA (mag stripe)/ BCD (keypad)
- Duhet të suportoje dy dalje lock(12V) dhe dy dalje Relay(kontakt)
- Centrali duhet të jetë i pajisur me ndërfaqe komunikimi RS-485, RS-232 dhe mundësi me RJ-45 duke e pasur në bordin e vet ose të jashtëm(Konvertues)
- Të ketë mundësi për Back up Battery deri në 2 bateri 7.2Ah.

Reader Indoor

Dokumentat Standarde të Tenderit

- Reader te punoje ne teknologjine Mifare me frekuence 13.56 Mhz
- Reader duhet te kete feedback akustik (buzzer) dhe visual (Led)
- Readers te komunikojne me centralin nepermjet komunikimit Serial
- Reader duhet te kete back light dhe te paraqese me ngjyra te vecanta evente te ndryshme(access granted, access denied, error..etc)

Software

- Software te kete mundesi te lidhet me centralet e aksesit ne dy menyra: Me porte seriale RS-232 dhe me rrjet RJ-45
- Software duhet te suportoje te pakten 1 Site
- Software duhet te suportoje deri ne 15 centrale aksesi per Site
- Software duhet komandoje te pakten 15 dyer per Site
- Software duhet te suportoje deri ne 500 karta punonjesish per 1 site
- Te kete mundesi instalimi ne Windows 7, Windows 10, Windows Server 2012, Windows Server 2008 R2
- Gjenerimin e raporteve te pergjithshem dhe specifike: raporte per system events, raporte per nje perdorues, raportet e nivelit te aksesit, raporte per time & attendance te nje punonjesi, ne formate te ndryshme si Exel, PDF, Notepad
- Te kete mundesi te gjeneroj raporte manuale, te paradefinuara, automatike, duke I spesifikuar saktesisht oren daten, kur duhet te gjenerohet raporti. Ky raport duhet te jete I personalizuar, me lista punonjesish te sektoreve, drejtorive, departamente te ndryshem sipas preferencese se burimeve njerezore.
- Raportet te mund te gjenerohen edhe te ruhen automatikisht ne Server (ose PC), edhe te mund te nisen automatikisht ne adrese emaili te percaktuar me pare.
- Te mundesoje konfigurimin e perdoruesit me informacionet personale dhe fotografi
- Te kete mundesi te shfaqjes ne moment te Fotove, kur karte mbajttesi kalon karten. Kjo per te verifikuar nese karta perdoret nga personi qe I perket.
- Mundesi krijimi Macro
- Krijimin e schedule te ndryshem per oraret e akseseve
- Krijimin e grupeve te aksesit

Dokumentat Standarde të Tenderit

- Software duhet te suportoje nderfaqe per kontroll parkimi per perdorim te mevonshem
- Sistemi duhet te ofroje mundesine te krijohen disa usera dhe i dhene kufizimet perkatese
- Te kete mundesine per Guard Tour. Nje opsion ky I perdorshme ne rastin e rojeve, qe verifikojne prezencen e tyre ne ate zone duke prezantuar karten ne reader perkates.
- Te kete mundesine e integritit te kamerave, per te bere lidhjen ndermjet cameras se asaj zone ku eshte instaluar reader, me readerin, per te bere verifikimin me video edhe foto te momentit te kalimit te kartes ne reader.
- Mundesi menaxhimi te Vizitoreve Ditore per perdorim me mevonshem. Edhe mundesi kontrolli on time te vendodhjes se tyre.
- Mundesi lokalizimi te cdo Karte Mbajtesi ne moment.
- Te kete mundesi te krijimit te Floor Plan, per te patur ne formen Live View, statusin nderveprimit te readers me kartat ne moment.
- Te kete mundesi zanore per cdo event, ose personalizim te tyre

Karta akses kontrolli

- Karta e akses kontrollit duhet te jene Mifare me frekuence 13.56Mhz

Duhet te jene te printueshme

Lista e produkteve

Objekti: “ Furnizim vendosje kamerat e qytetit, Bashkia Lushnje “

1. Sistem CCTV IP					
Nr	Artikulli	Pershkrimi	Njesia	Sasia	
1	NVR	NVR 64 kanale profesionale (RAID 5)	Cope	1	
2	Kamera te jashtme	Kamera 8 Megapixel IP Bullet	Cope	27	
3	Kamera PTZ	Kamera rrotulluese 360 grade, 2MP 48x	Cope	1	
4	Monitor	Monitor profesional per kamera 48"	Cope	4	
5	Switch POE	Switch POE me 5 porta	Cope	17	
6	Bazament	Bazament + mbajtese per kamerat	Cope	27	
7	Fiber	Fiber optike	ml	7000	
8	Kuti metalike	Kuti metalike, Kuti shperndarese kundra lageshtires per akses point e fibres, perfshihet multi prize, aksesore instalimi + Kosto instalimi	Cope	13	
9	Mediaconverter	Mediaconverter 10/100, single mode, single fiber 10 km.	Cope	13	

Dokumentat Standarde të Tenderit

10	Card Mediaconverter	Card Mediaconverter 10/100, single mode, single fiber 10 km	Cope	15	
11	Panel FO	Panel FO 12 Porta SC , sherben per terminimin e te gjitha fibrave	Cope	2	
12	Pigtails	Pigtails fiber optike Single Mode SC.	Cope	38	
13	Disketa	Kaseta per fiber optik	Cope	38	
14	Patchcorda	Patchcord FO, duplex SC -LC 1 ml	Cope	15	
15	Shasi Media Converter	Shasi media converter me 16 vende	Cope	2	
16	FTP Cat5	Kabell FTP Cat5 per instalimin e kamerave me akses pointin	ml	500	
17	Switch 24	Switch POE 24 porta, Switch 24 porta 10/100/1000 , Jo i menaxhueshem L2,Unmanaged, 16 10/100/1000Mbps,Back plane bandwidth: 32Gbps	Cope	1	
18	HDD 6TB	HDD 6TB I destinuar per video regjistrim	Cope	8	
19	Workstation	Workstation per menaxhimi e kamerave	Cope	1	
20	RAC	RAC 12U + Prize Racu	Cope	1	
21	UPS	UPS per RAC	Cope	1	
TOTALI					

2. Sistem Akses kontrolli (RAC Room)

	Artikulli	Pershkrimi	Sasia	Sasia	
22	Central aksesi	Central akses kontrolli per dy reader, me trasformator perfshire dhe kuti metalike	Cope	1	
23	Reader	Proximity reader	Cope	2	
24	Bateri 7A	Bateri 7A per centarlin per back up	Cope	2	
25	Converter	Converter RS485- LAN	Cope	1	
26	Karta	Karta akses kontrolli	Cope	5	
27	Kondrabrave	Kondrabrave elektrike	Cope	1	
28	Krahe hidraulik	Krahe hidraulik per deren	Cope	1	
TOTALI					

3. Sistem Alarmi (RAC Room) me UTC

	Artikulli	Pershkrimi	Sasia	Sasia	
29	Panel alarmi	Panel alarmi grada 3 e sigurise per rack room	Cope	1	
30	Tastiere alarmi	Tastiere alarmi me keypad dhe NFC Teknologji	Cope	1	
31	Sensore Levizje	Double teknologj sensore levizje	Cope	1	
32	Sensore temperature	Sensore temperature Raku. Per matjen e temperatures se ambientit.	Cope	1	
33	GSM	GSM/GPRS per thirrje telefonike	Cope	1	
34	Bateri 7A	Bateri 7A per centralin per back up	Cope	1	
35	Sirene	Sirene e jashtme	Cope	1	
36	Bateri 2.2A	Bateri 2.2A per sirenen e jashtme	Cope	1	
TOTALI					

Afati I vendosjes

10 (dhjetë) ditë kalendarike nga nënshkrimi i kontratës

Shtojca 11

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në Marrëveshjen Kuadër*]

**PLANIFIKIMI I
KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR**

Mall: Numri total i kontratave sipas Marrëveshjes Kuadër		
Kontrata Nr.	Titulli i Kontratës	Përshkrim i shkurtër i kontratës
01		
02		
03		
...		

Shtojca 12

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR¹

[vendi dhe data]

[emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006, Për Prokurimet Publike.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s'kualifikuat sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi siç parashikohet në Kreun VII të LPP-së.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt
< Emri >

Shtojca 13

[Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

2. _____

Dokumentat Standarde të Tenderit

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Përkatësisht për arsytet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [*emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues*] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [*shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*]/pikët totale të marra [_____] është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [*emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit*] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [*vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Dokumentat Standarde të Tenderit

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____ / Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____ /Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

Etj.____

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit], brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 15

KUSHTET E PËRGJITHSHME Mallrat –Kërkesë për propozim

Neni 1: Qëllimi

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për blerjen e Mallrave të prokuruarra me anë të procedurës me negociim.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2: Përkufizime

- 2.1 “kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktuesit që përbëhet nga Dokumentat e Tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha shtojcat dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.2 “çmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.3 “Incoterms” do të thotë termat ndërkombëtare tregtare që përbëjnë rregullat e interpretimit të termave tregtare që përcaktojnë detyrimet përkatëse, kostot, dhe risqet e lidhura me transferimin e Mallrave nga shitësi tek blerësi.

Dokumentat Standarde të Tenderit

- 2.4 “Lëvrimi” do të thotë të gjitha aktivitetet dhe veprimet që mundësojnë marrjen e Mallrave në vendin e shpërndarjes siç specifikohet në kontratë si paketimi, transportimi, sigurimi, tarifat, procedura doganore, ngarkimi dhe shkarkimi, instalimi, mbledhja, bashkimi, kontrollimi i veprimeve dhe mbikëqyrja e gjithë kësaj veprimtarie.
- 2.5 “Autoriteti Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen Mallrat. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.6 “Kontraktues” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate furnizon Mallrat.
- 2.7 “Palë (t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.8 “Mallrat” do të thotë materialet e papërpunuara, produktet, makineritë dhe pajisjet, objektet në formë të ngurtë, të lëngshme ose të gaztë.
- 2.9 “Shërbimet e lidhura me to” do të thotë shërbimet ndihmëse ose të paparashikuara të furnizimit të Mallrave, si transportimi, instalimi, mirëmbajtja, trajnimi, shërbimet mbështetëse ose detyrime të ngjashme në lidhje me furnizimin e Mallrave.
- 2.10 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Mallrat dhe Shërbimet e lidhura me to që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.11 “Standarde Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një organ i posaçëm standardizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarde të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose perkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.

Neni 3: Hartimi i Kontratës

- 3.1 Njoftimi i ofertës fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të parashikuar në Dokumentat e Tenderit.
- 3.2 Egzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke trupëzuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

Neni 4: Praktikant e Korrupsionit, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

- 4.1 Autoriteti Kontraktor mund t'i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se Kontraktuesi ka kryer veprime korruptive. Veprimet korruptive përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktuesi nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ndonjë ent tjetër që ka marrë pjesë në përgatitjen e Dokumentave të Tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktuesi duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që

kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t'i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 5: Informacioni Konfidencial

- 5.1 Kontraktuesi dhe Autoriteti Kontraktor duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktuesi mund t'i japë nënkontraktuesit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar për nënkontraktuesin të kryejë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, Kontraktuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me nën-Kontraktuesin një dispozitë që parashikon ruajtjen e konfidencialitetit siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

Neni 6: Pronësia Intelektuale

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga Kontraktuesi gjatë zbatimit të kontratës do t'i përkasin Autoritetin Kontraktor i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, Kontraktuesi, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i parashtrijë Autoriteti Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramet, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga Kontraktuesi gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktuesi mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, por nuk duhet t'i përdorë për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.
- 6.3 Kontraktuesi duhet të shkarkojë Autoritetin Kontraktor nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronësisë intelektuale që mund të dalin nga prodhimi ose shpërndarja e Mallrave sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronësisë intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i Mallrave të furnizuara sipas kontratës, Kontraktuesi duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të Kontraktuesit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

Neni 7: Origjina e Mallrave

- 7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së mallrave, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
- 7.2 Kontraktuesi mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e mallrave.
- 7.3 Për qëllime verifikimi, "origjinë" do të thotë vendi ku mallrat janë nxjerrë, ose prodhuar. Mallrat janë prodhuar kur, nëpërmjet përpunimit, procesimit, ose mbledhjes së

mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.

- 7.4 Origjina e mallrave ka dallim nga kombësia e Kontraktuesit ose nenkontraktuesit që siguron mallrat.

Neni 8: Qëllimi i Furnizimit dhe Përshtatshmëria e Mallrave me Specifikimet

- 8.1 Kontraktuesi duhet të dorëzojë Mallrat në përputhje me cilësinë, sasinë dhe llojin e specifikuar në kontratë, si dhe të vendosura dhe paketuara në mënyrën e përcaktuar në kontratë.
- 8.2 Mallrat nuk janë në përputhje me kontratën, nëse ato nuk janë të përshtatshme për përdorimin e posaçëm të parashikuar në kontratë. Kur nuk është e mundur të përcaktohet një gjë e tillë, thuhet se Mallrat nuk janë në përputhje me kontratën nëse ato nuk janë të përshtatshme për përdorimin për të cilin shërbejnë zakonisht sendet e tjera të të njëjtit lloj.
- 8.3 Nëse shitja është bërë në bazë të një modeli ose kampioni, shitësi (Kontraktuesi) duhet të dorëzojë sendet që kanë të njëjtat cilësi si të modelit ose kampionit.

Neni 9: Përputhshmëria e Mallrave me Standardet Teknike

- 9.1 Mallrat e furnizuara sipas kontratës duhet të jenë konform kodeve dhe Standardeve Teknike të parashikuara në specifikimet teknike. Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës, ka ndryshime në kodet përkatëse ose në Standardet Teknike, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pas aprovimit nga Autoriteti Kontraktor.
- 9.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet nga ndonjë dispozite tjetër e kontratës, kur nuk është përcaktuar asnjë Standard Teknik përkatës në specifikimet teknike, Mallrat duhet të jenë konform Standardeve Teknike ndërkombëtare. Nëse nuk ekzistojnë Standarde Teknike ndërkombëtare, Mallrat duhet të jenë konform Standardeve Teknike përkatëse Shqiptare.
- 9.3 Kontraktuesi nuk mban përgjegjësi për gabime në skicim, të dhëna, vizatim ose çdo aspekt tjetër të specifikimeve teknike të dhëna nga Autoriteti Kontraktor me përjashtim të rastit kur gabimi ishte aq i dukshëm sa Kontraktuesi duhet ta kishte parë dhe këshilluar Autoritetin Kontraktor për të.
- 9.4 Shitësi (Kontraktuesi) nuk mban përgjegjësi për defekte të Mallrave për të cilat Autoriteti Kontraktor ishte në dijeni në momentin e lidhjes së kontratës ose nuk ishte në dijeni për faj të tij, me përjashtim të rastit kur defektet kanë të bëjnë me cilësinë e Mallrave të specifikuar sipas kontratës ose përfaqësimin e reklamës se shitesit (Kontraktuesit).

Neni 10: Pjesët e Këmbimit

- 10.1 Nëse është e parashikuar në kontratë, Kontraktuesi duhet të përfshijë me Mallrat e lëvruara një sasi pjesësh këmbimi, në përputhje me specifikimet teknike dhe çdo dispozitë përkatëse të kontratës.

- 10.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe, pjesët e këmbimit do të dorëzohen bashkë me Mallrat.
- 10.3 Kontraktuesi duhet të garantojë disponueshmërinë e pjesëve të këmbimit për një periudhë të specifikuar në ofertën e tij dhe të barabartë me jetëgjatësinë e përdorimit të Mallrave.
- 10.4 Në rast të një vendimi të ndërprerjes së prodhimit të pjesëve të këmbimit, Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktor brenda një kohe të arsyeshme/mjaftueshme për t'i lënë mundësi atij që të prokurojë sasi të mjaftueshme për përdorim të mëvonshëm.
